



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 22.6.2023

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Bejko

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore publike të datës 19.6.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues, pasi konfirmoi njohjen e palëve me dokumentacionin shtesë të mbërritur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, në funksion të hetimeve të mëtejshme lidhur me tri denoncime të publikut, vendosi që aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimeve në kuadër të vlerësimit të aftësive të tij profesionale, të pranohen si provë nga trupi gjykues, i cili deklaroi më pas dhe mbylljen e hetimit.

Komisioneri Publik, ashtu sikurse u shpreh dhe në seancën e datës 19.6.2023, mban qëndrimin se aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës dhe aktet e depozituara nga subjekti, nuk ndikojnë në ndryshimin e kërimit përfundimtar dhe, për rrjedhojë, vlerësimin e tyre e lë në çmim të gjykatës.

Duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, referuar edhe parashtrimeve me shkrim të administruara gjatë këtij gjykimi, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, mbeti e provuar se:

### ***A. Për shkakun ankimor për vlerësimin e pasurisë:***

1. Lidhur me pasurinë, apartament me sip. 96.5 m<sup>2</sup> në \*\*\*, kompleksi \*\*\* \*\*\*, Tiranë, mbi burimin e deklaruar të krijimit të shumës 47.000 euro, deklaruar në Vetting dhënë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament në vitin 2007, në vlerën 90.000 euro

1.1 Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të parashtruar gjerësisht në shkaqet e ankimit dhe në seancë gjyqësore, vlerëson që mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit:

1.1.1 Në DV-2008, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., pagesën në shumën 20.000<sup>1</sup> euro, të kryer në prill të vitit 2008, si dhe burimin e krijimit të saj. Kjo marrëdhënie kontraktuale nuk është saktësuar nga subjekti as në Deklaratën “Vetting”, në kushtet kur shuma e kthyer nga kjo shoqëri ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit që subjekti i rivlerësimit ka aktualisht në pronësi.

1.1.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DV-2008 kreditë konsumatore në shumën totale 9.000 euro, të marra nga ai dhe personi i lidhur me të në \*\*\* Bank, shlyerjen e parakohshme të kredive konsumatore dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre.

1.1.3 Për herë të parë, burimi i krijimit për shlyerjen e parakohshme të kredive është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në Deklaratën “Vetting”, me burim fondet e familjes së znj. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. Ky burim krijimi është i ndryshëm nga burimi i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, çka bie në kundërshtim me parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet qartë se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

1.2 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe kontradiktore në Deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit administrativ, mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklarimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume.

1.2.1 Pasaktësitë në deklarimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. *Lidhur me pasurinë automjet tip Daimler Chrysler, E270 CDI, blerë në Gjermani nga subjekti i rivlerësimit më datë \*\*.4.2007*

2.1 Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje, për sa parashtruar gjerësisht në shkaqet e ankimit, vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, për sa në vijim:

2.1.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, blerjen, burimin e krijimit, shitjen dhe as të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti. Ekzistenca e akteve noteriale me përshkrimin e të drejtave të subjektit mbi këtë pasuri tregon, në kuptim formal, deri në provimin e së kundërtës, se këto të drejta i përkasin pikërisht subjektit të rivlerësimit, prandaj ai kishte detyrimin, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, t'i deklaronte ato.

2.1.2 Pretendimet e subjektit mbi konsiderimin *si lapsus* të shumës 500.000 lekë, të parashikuar në kontratën e shitjes, mbeten në nivel deklarativ dhe duket se subjekti kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së luajtshme. Në kontekst të kësaj situatë faktike dhe ligjore, në dijeni të plotë të subjektit të

---

<sup>1</sup> Nga aktet rezultojnë se janë paguar 8.000 euro nga llogaria e babait të subjektit të rivlerësimit, 9.000 euro nga llogaria e subjektit të rivlerësimit për llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe nuk ka të dhëna mbi diferencën për shumën 3.000 euro.

rivlerësimit pas komunikimeve me institucionin përgjegjës për kontrollin e verifikimin e pasurisë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kishte ndërgjegjësimin e duhur për të deklaruar këtë marrëdhënie të tij me këtë pasuri në Deklaratën “Vetting”, qoftë edhe sikur të bënte në të shpjegimet e nevojshme apo të përshtatshme të rastit, sipas pretendimit të tij gjatë hetimit administrativ. Deklarimet e subjektit se e ka blerë këtë automjet vetëm për të ndihmuar shtetasin / “*shokun tim*” \*\*\*,\*\*\*, bien ndesh me përmbajtjen e kontratës, ku referohet se palët nuk njihen. Në këto rrethana mbetet e paqartë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*,\*\*\*.

2.2 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

3. *Lidhur me pasurinë automjeti tip Mercedes Benz, me targa belge, \*\*\* \*\**

3.1.1 Komisioneri Publik, për sa parashtruar gjerësisht në shkaqet e ankimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të interesave vjetorë të vitit 2008, blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, vlerën dhe as burimin e krijimit të kësaj shume, duke u ndodhur në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

3.1.2 Gjithashtu, Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ mbi këtë pasuri/mjet, deklarimet kontradiktore, çështjet e pahetuara mbi rrethanat e vjedhjes së mjetit<sup>2</sup>, shtetasit e përfshirë në transaksionin e blerjes, të cilat mbesin në nivel deklarativ, mungesa e arsytimit ligjor në vendimin e pushimit të procedimit penal nr.\*\*\*/2006, më së paku, shfaqin qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit dhe janë elemente, të cilat duhen vlerësuar nga Kolegji, në drejtim të parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. *Lidhur me transaksione bankare të kryera nga personi i lidhur \*\*\*, \*\*\*(\*\*\*)*

4.1 Komisioneri Publik, për sa trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit, vëren se, nga analizimi në tërësi i transaksioneve të kryera në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit dhe babait të subjektit të rivlerësimit, duket se, më së paku, depozitimi i shumave, në llogarinë e personit të lidhur në \*\*\* Bank<sup>3</sup>, korrespondon me tërheqjen e të njëjtave shuma në të njëjtën datë, nga llogaria bankare e babait të subjektit, në \*\*\* Bank, çka bie ndesh me deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

#### **B. Për shkakun ankimor lidhur me vlerësimin e figurës dhe gjetjet në raportin e DSIK-së**

5. Komisioneri Publik, për sa trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit, në përfundim për kontrollin e kriterit të figurës, vlerëson se nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, në vlerësim të përgjithshëm të të tria

<sup>2</sup> Nga fashikulli nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime hetimore për këtë kallëzim. Në lidhje me këtë konstatim, rezulton se Komisioni i ka kaluar barrë prove dhe kërkuar shpjegime dhe një subjekti tjetër rivlerësimi, z. \*\*\*,\*\*\*, që rezulton të ketë qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes. Referohuni vendimit të publikuar në faqen zyrtare, nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, f. 41 e tij.

<sup>3</sup> Disa prej këtyre transaksioneve, për të cilat është pyetur subjekti, janë kryer gjatë vitit 2010, pas martesës ligjore të subjektit të rivlerësimit me znj. \*\*\*. Konkretisht: (i) Në datën \*\* 2.2010 është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. \*\*\*,\*\*\*, në \*\*\* Bank, shuma 9.000 euro. Kjo shumë është tërhequr po *cash* në datën \*\*.3.2010. (ii) Në datën \*\*.8.2010 është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. \*\*\*,\*\*\*, pranë \*\*\* Bank, shuma 1.095.000 lekë, e cila është tërhequr një ditë më pas.

kritereve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nëse në to ka elemente që duhen trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pa i nxjerrë nga kriteri i kontrollit të figurës.

### **C. Për shkakun ankimor, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale**

6. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të mbajtura në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se mangësitë e konstatuara në çështjet e trajtuara, janë të bazuara dhe nuk u arrit të provohet e kundërta as në parashtrimet e paraqitura gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore. Konkretisht për:

7. *Procedimin penal nr. \*\*\*/2017*, Komisioneri Publik vlerëson se nga aktet e administruara, duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

8. *Denoncimin<sup>4</sup> e shtetasit \*\*\*.\*\*\**, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi mosrespektimi i afateve ligjore, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

9. *Denoncimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\**, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, trajtuar në shkaqet e ankimit, bie ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

### **Kërkimi i ankimit**

10. Duke përfunduar për sa parashtruam, Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 61, pikat 3, dhe 5, të ligjit nr. 84/2016; dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Bejko.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**

<sup>4</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.8.2018.